

## **Programi iv: Qytetet “e zgjuar” dhe rritja urbane.**

### **QYTETET “E ZGJUAR” DHE RRIJTJA URBANE.**

Një objektiv thelbësor i perspektivës së "qyteteve të zgjuar" ka të bëjë me zhvillimin e komunitetit, duke kërkuar të fuqizojë individët dhe grupet lokale duke u siguruar atyre aftësi dhe informacion të nevojshëm për të ndikuar në ndryshimet në komunitetet e tyre dhe nxitur novatorizmin. Qyteti inteligjent është një sipermarrje novatore që siguron një ekuilibër midis faktorëve socialë, ekonomikë, mjedisorë, njerëzorë, kulturorë dhe teknologjikë.. Zhvillimi i komunitetit përfaqëson një proces ndryshimi, ku pjesëmarrja dhe veprimi kolektiv kanë një rëndësi thelbësore.

#### **Përkufizimi i Qytetit të Zgjuar**

Koncepti i Qytetit “të Zgjuar” shfaqet në vitet '90, i nxitur nga strategjitë e zhvillimit të zbatuara në qytete në zonën e Azi-Paqësorit, në të cilat Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) luajnë një rol themelor. Përhapja e rrjeteve elektronike në qytet ndihmon në formulimin e modelit të qytetit mbi të cilin vendosen pritjet e reja të rritjes. Ky model i ri urban identifikohet me konceptin e Qytetit të Zgjuar, qytetit të së ardhmes.

Në lidhje me ekonominë, një qytet 'i zgjuar' mund të jetë një qytet që mirëpret një industri 'të zgjuar' (d.m.th. një industri që është ose një prodhues ose një përdorues i gjerë i TIK-ve inovative,) ose një qytet i cili zhvillon parqe biznesi të bazuara në TIK në territorin e tij. Përdoret gjithashtu për të përshkruar një qytet me banorë 'të zgjuar' (d.m.th. burime njerëzore lokale të mirëarsimuar) ose një qytet ku bashkëveprimi G2C (qeveri të qytetari) bazohet shumë në TIK (e-qeverisja ); ose një qytet që shfaq një pjesëmarrje të fortë, të mundshme për TIK, në proceset e vendimmarrjes lokale (e-demokracia). Për më tepër, ai mund t'i referohet një qyteti që shfrytëzon mundësitë e përdorimit të TIK-moderne në proceset urbane me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët e tij (p.sh. sistemet e transportit "të zgjuar" në mbështetje të menaxhimit të trafikut urban). Më në fund, termi përdoret për të përshkruar një qytet që përdor TIK për të përmirësuar shërbimet në disa fusha, p.sh. siguria, shëndeti, zhvillimi “i gjelber”, ose konsumi i qëndrueshëm i energjisë.

## **A janë qytetet inteligjente përgjigja për sfidat e urbanizimit?**

Sipas një studimi nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, "55% e popullsisë së botës jeton në zona urbane, një përqindje që pritet të rritet në 68% deri në 2050". E njëjta tendence është edhe në Shqipëri: Në Censusin e vitit 2011, për herë të parë në historinë e vendit, popullsia që jeton në zonat urbane e tejkaloi popullsinë e zonave rurale.

Në fakt nuk ka asgjë të re në lidhje me urbanizimin, megjithatë, sikurse është parashikuar në vitet që vijnë, ritmi i urbanizimit do të jetë më i shpejti në vendet me të ardhura të ulëta. Shumë vende do të përballen me sfida në plotësimin e nevojave të popullatave të tyre në rritje urbane, duke përfshirë strehimin, transportin, sistemet e energjisë dhe infrastrukturën tjetër, si dhe për punësimin dhe shërbimet themelore të tilla si arsimi dhe kujdesi shëndetësor. Në këtë kontekst, politikat e integruara për të menaxhuar rritjen urbane që garantojnë aksesin në infrastrukturë dhe shërbimet sociale për të gjithë do të bëhen të një rëndësie jetike.

Të kesh akses në këtë lloj informacioni duhet të motivojë vendet për të përmirësuar planifikimin dhe administrimin e qytetit (dhe madje edhe të vendit), dhe t'i bëjë ato të punojnë në një plan të qëndrueshëm qeveritar për zhvillim me qëllim që të maksimizojnë mundësitë ekonomike të popullsisë dhe minimizojnë dëmtimin e mjedisit.

Ndërsa jemi duke u përballuar me fenomenin e urbanizimit në të gjithë botën, pyetja që mund të shtrojmë vetes është: a kanë me të vërtetë zonat urbane hapësirë për 2.5 miliardë njerëz shtesë të parashikuar të jetojnë në qytete deri në vitin 2050 dhe çfarë pasojash mjedisore dhe sociale mund të prodhojë kjo zhvendosje. Nismat e ndryshme të Qyteteve "te Zgjuar" shpesh janë renditur si strategjia më e mirë për të përballuar sfidat e shumta që përbën rritja e popullsisë urbane dhe për të arritur qëllimet globale të zhvillimit të qëndrueshëm.

## **Dimensionet dixhitale të "qyteteve të zgjuara"**

Qyteti "i zgjuar" mund t'u ofrojë qytetarëve dhe bizneseve lokale një sërë mjetesh dhe aplikimesh të TIK që mund të nxisin sjellje inovative. Këto aplikacione krijojnë ambiente

virtuale, duke mbështetur si zgjedhjet individuale, ashtu edhe opsionet e komunikim – bashkëpunimit në grup. I gjithë rreziku i aplikacioneve mund të klasifikohet në grupet vijuese:

*e-Informacioni*. Informacioni elektronik: i referohet sigurimit të llojeve të ndryshme të informacionit për një gamë të gjerë të audiencës, p.sh. qytetarët, vizitorët, bizneset, institucionet;

*e-Business*: i referohet potencialit të ofruar për bizneset për shfrytëzimin e mundësive të biznesit elektronik, adoptimin e modeleve të ndërveprimit të biznesit me biznesin (B2B) dhe të biznesit me klientin (B2C), miratimin e strategjive të reja inovative për e - shënimin e produkteve të tyre etj;

*e-Marketingu*: mbështet një gamë të mundësive të marketingut elektronik për një qytet / bashki në promovimin e imazhit të qytetit (produktet, vendet arkeologjike, asetet kulturore, etj);

*e-qeverisja*: i referohet sigurimit, në një mënyrë më efektive, të shërbimeve për qytetarët, bizneset dhe institucionet qeveritare (bashkëveprimi G2C, G2B dhe G2G);

*e-Inovacioni*: i referohet potencialit për bashkëpunim elektronik dhe zhvillimit on-line të produkteve të reja;

*-E-Pjesëmarrja*: i referohet potencialit në rritje për përfshirje elektronike të qytetarëve, duke forcuar kështu pjesëmarrjen aktive në proceset e vendimmarrjes (e-Demokracia).

### **Çështjet kryesore te Qytetit “të Zgjuar”**

Në mënyrë që të arrihet administrimi dhe projeksioni i saktë i përmirësimeve në qytete, është e nevojshme të kemi një përmbledhje të asaj që po ndodh atje dhe në rrethinat e tyre. Në UniBA, ne mbulojmë me sukses të gjitha çështjet kryesore te Qytetit “të Zgjuar”, të tilla si:

- Zhvillim i qëndrueshëm urban;
- Ndërtesat dhe pajisje të qëndrueshme;
- Infrastrukturat dhe lëvizshmëria;
- Qëndrueshmëria dhe ekonomia rrethore (cirkulare);

- ❑ Infrastruktura e rrjeteve inteligjente;
- ❑ Sigurimi i shërbimeve urbane;
- ❑ Qytetarët, qeveria dhe vlerësimi i të dhënave.

Si rezultat, ideja e Smart City shoqërohet sot me një "qytet të gjelbër" të lidhur, efikas, inovativ, i cili është forca lëvizëse e sipërmarrjes së bazuar në teknologji. Është propozuar dhe miratuar gjerësisht një model i gjashtë akseve që të gjithë korrespondojnë me një sërë atributesh që ndihmojnë në identifikimin e një qyteti të zgjuar (Giffinger et al, 2007):

Ne mund të identifikojmë dy modele të konceptimit të Qytetit të Zgjuar. Nga njëra anë, ekziston qasja më teknocentrike (e promovuar nga sektori i TIK) sipas së cilës, proceset dhe shërbimet urbane mund të bëhen më efikase dhe efektive në një qytet të lidhur. Mbledhja masive e të dhënave dhe shndërrimi i tyre në informacion përmes mjeteve të fuqishme të analizës lejon përmirësimin e menaxhimit urban. Sipas kësaj qasjeje, Qyteti i zgjuar mund të përdoret për shembull për të përshkruar një qytet me një industri "të zgjuar".

Nga ana tjetër, ekziston një qasje holistike ndaj konceptit, që e lidh atë me një ekuilibër midis faktorëve socialë, ekonomikë, mjedisorë, njerëzorë, kulturorë dhe teknologjikë. Ndërsa gjithnjë e më shumë projekte të vërteta të Qytetit të zgjuar fillojnë, nevojat dhe interesat e qyteteve dhe qytetarëve bëhen më të qarta, si dhe pengesat me të cilat përballen çdo ditë. Konceptimi holistik i Qytetit të zgjuar është rritur në akademi si një përgjigje ndaj sfidave që qytetet duhet t'u përgjigjen, të tilla si ndryshimi i klimës, zhvillimi ekonomik, efikasiteti në përdorimin e burimeve, etj.

### **Partneriteti (Quadruple Helix) i Programit:**

Qytetet inteligjente prezantojnë një larmi praktikash dhe shërbimesh të reja të cilat ndikojnë në hartimin dhe planifikimin e politikave urbane pasi ato bashkëjetojnë me objektet urbane. Dhe ka mënyra të ndryshme që kuadri inteligjent i qytetit mund të ndihmojë planifikuesit e qytetit për të

përbushur kriteret e sipërpërmendura dhe për të kontribuar në një jetë urbane. Arkitektura gjenerike e një qyteti inteligjent përmban shtresën e mëposhtme:

1. Shtresa e përdoruesit,
2. Shtresa e Shërbimit,
3. Shtresa e Infrastrukturës dhe
4. Shtresa e të Dhënave.

Nëse shikohet nga afër, ne mund të vëzhgojmë se si ato shtresa lidhen të gjitha në një mënyrë apo në një tjetër me kriteret e planifikimit urban.

Për shembull, në mënyrë ideale, shtresa e infrastrukturës nuk duhet të ngarkojë mjedisin lokal ose zonat lokale të mbrojtura dhe duhet të planifikojë të zhvillojë në mënyrë uniforme qytete inteligjente nëpër rajone për një zhvillim koherent. Kur bëhet fjalë për shtresën e Shërbimit, shërbimet e transportit inteligjent do të përputhen drejtpërdrejt me cilësinë dhe dimensionet e planifikimit të Kohëzgjatjes së Qëndrueshmërisë.

Ose e kundërta: si mund të plotësohen kriteret falë një ose më shumë shtresave. Për shembull, të dhënat mjedisore që janë mbledhur nga sensorët mund të kontribuojnë në cilësinë, historinë dhe dimensionet e peizazhit.

Pra, ajo që mund të vëzhgojmë është një lidhje dy-drejtimëshe midis politikës së zhvillimit urban dhe kornizës së qytetit “të zgjuar”. Qyteti i “zgjuar” përshtatet lehtësisht me dimensionet e planifikimit urban, ndërsa politikat e zhvillimit urban duhet të jenë në vëzhgim për të kapitalizuar atë që ofrojnë zgjidhjet e qytetit të zgjuar.

### **Linjat e veprimit të PROGRAMIT:**

Qytetet mbështeten në një rrjet kompleks të sistemeve dhe shërbimeve për të mbijetuar. Në UniBA, ne kemi kuptuar se si mund të përdoret teknologjia për të ndihmuar rritjen e qyteteve.

*1. Qytetet e “zgjuar” si mjete për zhvillimin urban por me njerëzit në qendër.*

UniBA i sheh qytetet inteligjente si një nga mjetet për zhvillimin urban, me njerëzit në qendër të procesit. Ne këshillojmë politikë-bërësit, drejtuesit, bashkitë, zhvilluesit dhe industrinë në marrjen e vendimve sesa mund të investojnë dhe sa vlerë mund të marrin nga të qenit 'i zgjuar'. Gama jonë e shërbimeve përfshin strategjinë dhe organizimin, informatikën urbane, sistemet e biznesit dhe arkitekturën, dhe këshillat për infrastrukturën që, të marra së bashku ose individualisht, do të ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve inteligjente.

## 2. Identifikimi i vlerave të teknologjisë inteligjente.

Ne, në UniBA punojmë me organizata të ndryshme, përfshirë qeverinë dhe pushtetin lokal si edhe me klientët nga industria, për të ndihmuar të kuptojnë se çfarë mund të thotë 'i zgjuar' për qytetin e tyre, të identifikojnë vlerën që teknologjia inteligjente do të krijojë dhe të kuptojë mundësitë që paraqesin qytetet inteligjente. Teknologjia sjell përfitime më të mëdha për qytetet kur përdoret në një mënyrë të hapur dhe bashkëpunuese. Ne besojmë se infrastruktura dixhitale duhet të projektohet në një mënyrë që të mundësojë fleksibilitet ndaj nevojave të ndryshme.

## 3. Implementimi i zgjuar:

UniBA mbështetet në disiplina të ndryshme, përfshirë inxhinierinë, arkitekturën, modelin urban dhe ekonominë, për të hartuar plane dhe sisteme të teknologjisë inteligjente. Ne punojmë me të gjithë palët e interesuara për të udhëhequr zbatimin e tyre, duke përcaktuar se si ata mund të financohen dhe qeverisen, si dhe përshkruajnë përbërjen e tyre teknike.

## 4. Zhvillimi i komunitetit:

Një objektivi thelbësor i punës së UniBA lidhur me perspektivën e "qyteteve të zgjuar" ka të bëjë me zhvillimin e komunitetit, duke kërkuar të fuqizojë individët dhe grupet lokale duke u siguruar atyre aftësi dhe informacion të nevojshëm për të ndikuar në ndryshimet në komunitetet e tyre. Zhvillimi i komunitetit përfaqëson një proces ndryshimi, ku pjesëmarrja dhe veprimi kolektiv kanë një rëndësi thelbësore. Kjo nënkupton një komunitet ku individët ndihmohen të fitojnë aftësi dhe kompetenca dhe të zhvillojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre, një kërkesë për pjesëmarrjen e tyre demokratike në një tërësi problemesh të komunitetit. Zhvillimi i komunitetit

krijon bazën për ndërtimin e bashkësive që bazohen në drejtësi, barazi, respekt të ndërsjellë dhe bashkëpunim; ai gjithashtu formon gur-themelin për krijimin e marrëdhënieve dhe rrjetëzimit, duke forcuar kështu lidhjet dhe mirëkuptimin midis qytetarëve, si dhe shfrytëzimin në mënyrë krijuese të njohurive dhe përvojave lokale. Për më tepër, vlerësohet si një hap për të ndikuar në marrëdhëniet e pushtetit dhe rolin e tyre në vendimet e politikave, duke ndryshuar pozicionin e njerëzve të zakonshëm dhe potencialin e tyre për të ndikuar në vendimmarrjen lokale.

### **Projekte te evidentuara:**

1. Bashkëpunin me Bashkite: Si të krijojnë një partneritet ndërmjet agjencive dhe organizatave të ndryshme në qytet për zbatimin e projekteve të teknologjisë inteligjente për të përfituar të gjithë qytetarët.
2. Sensing city: Vendosija e sensorëve që mbledhin informacion në kohë reale rreth mënyrës se si funksionon qyteti për të gjetur mënyra për t'i shërbyer më mirë qytetarëve të tij.

### **Sektorët ku përqëndrohen drejtimet kryesore të programit sipas niveleve perkatese janë:**

#### **1. Ekonomi e zgjuar (konkureshmëri)**

Frymë inovative

Sipërmarrja

Imazhi ekonomik dhe markat tregtare

Produktiviteti

Fleksibiliteti i tregut të punës

Aftësia për tu transformuar

#### **2. Njerëz te zgjuar (Kapitali Njerezor dhe Social)**

Niveli i kualifikimit



Afiniteti për të mësuarit gjatë gjithë jetës

Pluraliteti shoqëror dhe etnik

Fleksibiliteti

Kreativiteti

Mendja e Hapur

Pjesëmarrja në jetën publike

### **3. Qeverisja e zgjuar (Pjesëmarrja)**

Pjesëmarrja në vendimmarrje

Shërbimet publike dhe sociale

Qeverisja transparente

Strategji politike & perspektivat

### **4. Lëvizja e zgjuar (Transporti dhe TIK)**

Aksesi lokal

Aksesi (ndër) kombëtar

Disponueshmëria e infrastrukturës së TIK-ut

Sisteme transporti të qëndrueshëm, inovativ dhe i sigurt

### **5. Mjedis i zgjuar (Burimet Natyrore)**

Kushte natyrore tërheqëse (atraktive)

Ndotja

Mbrojtja e mjedisit

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve

### **6. Jetesë e zgjuar (Cilësia e Jetës)**





Objektet kulturore

Kushtet shëndetësore

Siguria individuale

Cilësia e strehimit

Objektet arsimore

Atraksionet turistike

Kohezioni shoqëror